



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01/Kuvendi i Komunës

Nr./Br./No 01/65 Nr. i faq./Br. str./No. pg 80

Data/Datum/Date 30.06.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 14/2019"), nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.06.2025, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025 - 2028

1. Me këtë vendim **miratohet** Plani i Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025 - 2028 në komunën e Rahovecit.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijëve 2025 – 2028.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Ekipi Komunal për të Drejtat e Fëmijëve në Komunën e Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorëve të Drejtorive,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.65/25
Datë:30.06.2025



Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit